




Worldwide Partner



FESTO LIVE ME RAIFFEISEN BANK NË FIFA WORLD CUP 26TM, MUNDËSUAR NGA VISA



Bëhu pjesë e llotarisë nga data 15 Dhjetor 2025 - 31 Janar 2026. Mëso më shumë në www.raiffeisen.al

RREGULLORE

MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË LOJËS PROMOCIONALE

Me qëllim që të përcaktohen rregullat dhe mënyra e organizimit të lojës promovionale për klientët individë, të cilët do të përdorin kartat e debitit VISA, gjatë periudhës **15 Dhjetor 2025 – 31 Janar 2026**, në zbatim të pikës 1, Kreu II, të VKM nr.196, datë 15.3.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, formave, kritereve dhe rregullave për organizimin e lojërave të fatit promovionale", Departamenti i Marketingut dhe Departamenti i Bankingut Ditor & Biznesi me Kartat, nxjerrin këtë Rregullore:

> Lloji i lojës promovionale

Duke filluar nga data **15 Dhjetor 2025 – 31 Janar 2026**, Raiffesen Bank Sh.a në bashkëpunim me VISA (Visa International Service Association) do të organizojë një lojë promovionale për të gjithë klientët individë (ekzistues dhe të rinj), që do të përdorin kartat e debitit VISA nga Raiffeisen Bank, për pagesa me kartë brenda dhe jashtë vendit. Kjo lojë zhvillohet me qëllim promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Raiffeisen Bank Sh.a.

Në lojën promovionale do të konsiderohen të vlefshme të gjitha veprimet e kryera me kartat e debitit VISA nga Raiffeisen, në pikat e Shitjes (POS), si dhe për pagesat online, brenda dhe jashtë vendit, të autorizuara si të suksesshme gjatë periudhës së lojës promovionale. Mbas përfundimit të periudhës promovionale do të hidhet një shorte për të përzgjedhur 1 (një) klient fitues.

> Kohëzgjatja e lojës

Kalendari promociional fillon më datë 15 Dhjetor 2025 – 31 Janar 2026. Në rast se autorizimi nga AMLF, do të jepet mbas datës 15 Dhjetor 2025, kalendari promociional do të fillojë nga data e dhënies së autorizimit.

Shorteu për çmimin fitues do të hidhet më datë **16 Shkurt 2026**. Njoftimi për datën dhe orën e ndarjes së çmimeve, do të depozitohet pranë AMLF dhe organit tatimor, 20 (njëzet) ditë përpara datës së zhvillimit të shorteut.

> Numri i çmimeve dhe mënyra e shpërblimit të fituesve

Mbas përfundimit të periudhës së promocionit, do të jepet 1 (një) çmim për 1 (një) fitues. Çmimi konsiston në ofrimin e paketës, për 2 (dy) persona të rritur, për të ndjekur një ndeshje futbolli, të Kampionatit Botëror të Futbollit, që do të zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (11 Qershor 2026 - 19 Korrik 2026). Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të hyrjes në stadium, do të mbulohen nga VISA dhe Raiffeisen Bank. Në mënyrë të specifikuar, shpenzimet që përfshin paketa e çmimit, jepen në pikën 5.1 të Rregullores.

Kartëmbajtësi që shpallet fitues i një prej çmimeve nuk ka të drejtë ta transferojë çmimin tek persona të tretë.

> Kosto për pjesëmarrësit

Klientët individë që do të jenë pjesë e kësaj loje promotionale nuk kanë kosto shtesë për pjesëmarrjen në këtë promocion. Ata janë të ftuar të përdorin kartën e debitit VISA Classic ose VISA Gold, sipas kushteve të përcaktuara për të qenë pjesë e shorteut.

> Vlera monetare e çmimeve të ofruara / Tatimi në burim

VLERA MONETARE E ÇMIMIT TË UDHËTIMIT:

Paketa 25,000 USD + shpenzime transporti, shpenzime ditore dhe shpenzimet për aplikimin e vizës ~ vlerë \$1,900* .

Paketa e ofruar nga VISA prej 25,000 USD për 2 persona, mbulon shpenzimet:

- Akomodim për 4 netë në hotel me 4 yje.
- 1 ndeshje e Kupës së Botës FIFA 2026 (Biletë e Kategorisë 1).
- Kartë Visa e parapaguar- vlerë \$600 USD.
- Transferimi nga/ tek aeroporti.
- Mëngjesi dhe ushqime të përditshme në hotel.
- Transport për në/nga ngjarjet e planifikuara.
- Dhurata / Pajisje - vlerë \$400.
- Aktivitet/eksperiencë kulturore.
- Pritje nga përfaqësues të Visa në hotel.
- Staf suportues nga Visa për çdo event (përfshirë çështje shëndetësore apo sigurie).

Shpenzime të tjera:

- Bileta e udhëtimit
Tiranë - SHBA ~ vlerë \$1,000*
- Kosto e aplikimit për Vizë amerikane në Ambasadën Amerikane – vlerë \$435
- Para për shpenzime ditore vlerë \$400

> Vlera monetare e biletës së udhëtimit ndryshon në varësi të disponibilitetit dhe çmimeve të ofrura në momentin e kryerjes së blerjes së biletës. Ky informacion do të depozitohet pranë AMLF në momentin e kryerjes së blerjes së biletës.

Për të ardhurat që do të realizojnë fituesit e lojës promotionale, Raiffeisen Bank sh.a. do të mbajë tatimin në burim dhe do ta derdhë atë në llogarinë e organit tatimor, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

> **Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në lojë**

Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në lojë do të jetë rreth 25,000 klientë.

Probabiliteti: 0.004% për klient.

> **Pjesëmarrësit që kanë të drejtë të marrin pjesë në lojë / Kufizimet**

Konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në lojën promovionale të gjithë klientët e Raiffeisen Bank Sh.a. (ekzistues dhe te rinj) që kanë një kartë debiti VISA dhe që do të plotësojnë kushtet si më poshtë:

- > Të kenë kryer minimumi 5 (pesë) transaksione të suksesshme/ të vlefshme në pika shitje POS, apo pagesa online, brenda ose jashtë vendit, gjatë periudhës së fushatës (15 Dhjetor 2025 - 31 Janar 2026), me vlerë të përgjithshme jo më pak se 5,000 Lekë.

Numri i transaksioneve që mund të kryejë çdo kartëmbajtës për t'u bërë pjesë e lojës është i pakufizuar, mjafton që të përmbushet kriteri i numrit minimal të transaksioneve dhe vlerës minimale.

Nëse klienti ka kartë shtesë në llogari në emër të një klienti tjetër, transaksionet e kryera me këtë kartë do të llogariten si transaksione të kryera nga kartëmbajtësi i kartës shtesë.

Nuk do të llogariten transaksionet e kryera me karta që janë të lidhura me llogari biznesi të klientit.

Nuk konsiderohen transaksione të vlefshme me kartë për lojën promovionale, ato veprime që rezultojnë të pasuksesshme ose për të cilat është kryer veprimi i kthimit mbrapsht të vlerës (refund).

Stafi i Raiffeisen Bank Sh.a, Raiffeisen Invest Sh.a dhe Raiffeisen Leasing Sh.a. nuk do të përfshihen në këtë shorte. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe kartat shtesë për këtë kategori.

> **Mënyra e përzgjedhjes së fituesve dhe vendi ku do të bëhet përzgjedhja**

Pas përfundimit të periudhës së promovionit do të gjenerohet një listë me të gjithë klientët individë që kanë përdorur kartat e debitit VISA dhe që kanë plotësuar kushtet për të qenë pjesë e shorteut. Informacioni për të gjithë klientët do të përpunohet nga data 9 Shkurt 2026 – 13 Shkurt 2026.

Shorteu do të zhvillohet me datë 16 Shkurt 2026, në zyrat qendrore të Raiffeisen Bank sh.a. në adresën: Rruga "Tish Daija", Kompleksi KIKA 2, Tirane.

Përzgjedhja e fituesve do të bëhet nëpërmjet një programi kompjuterik.

Mbas shpalljes së fituesve, organizatori i lojës do të përzgjedhë edhe 10 (dhjetë) emra të tjerë (rezervë) në prani të komisionit, të cilëve do t'u akordohet çmimi në rast se fituesi:

- a. nuk ka një mjet të vlefshëm identifikimi;
- b. refuzon të marrë çmimin e ofruar nga Banka;
- c. nuk është pajisur me vizë nga ana e SHBA.

Në rast se fituesi i përzgjedhur nuk përmbush kriteret në pikën 8.4, fituesi rezervë sipas renditjes, do të njoftohet për çmimin dhe do të udhëzohet për të filluar procedurën për aplikimin për vizë.

Nëse fituesi i parë rezervë nuk pajiset me vizë nga ana e SHBA, procesi do të vijojë njësoj edhe për fituesit e tjere rezervë deri në përfundim të rezervave ose brenda kohës së mundshme për të udhëtuar.

Duke qënë se dhënia e çmimit është e kushtëzuar nga pajisja e fituesit me vizë hyrëse në SHBA dhe marrja e vizës është e varur nga autoritetet përkatëse, Banka nuk ka asnjë përgjegjësi që lidhet me procesin e aplikimit, vonesat apo refuzimet. Në rast se vizën nuk e përfiton asnjë nga fituesit e përzgjedhur brenda afatit të realizimit të udhëtimit, nuk do të jepet çmimi dhe asnjë kompensim tjetër alternativ.

Mënyra e njoftimit të fituesit

Fituesit do të njoftohen me telefon ose e-mail nga ana e Bankës, duke ju referuar numrit të telefonit dhe adresës elektronike që kanë të regjistruar në sistemet e Raiffeisen Bank. Njoftimi i fituesve nëpërmjet telefonatës dhe me e-mail do të bëhet nga ana e Contact Center (Njësia e Kontaktit me Klientin).

Çdo klient fitues duhet të konfirmojë pranimin e çmimit brenda 24 orësh nga telefonata ose marrja e e-mailit në adresën elektronike, nëpërmjet telefonatës ose e-mailit. Nëse kartëmbajtësi fitues nuk konfirmon pranimin e çmimit brenda afatit të mësipërm, e humb të drejtën e përfitimit të çmimit fitues. Në këto kushte, Bankës i lind e drejta ta transferojë çmimin tek klienti i radhës, nga lista e fituesve rezervë të përzgjedhur sipas pikës 8.4.

Fituesit e radhës do të njoftohen në të njëjtën mënyrë, me telefon ose e-mail nga ana e Bankës. Kartëmbajtësi duhet të konfirmojë pranimin e çmimit brenda 24 orësh nga telefonata, ose dërgimi i njoftimit në adresën elektronike.

Klienti fitues që ka konfirmuar pranimin e çmimit, duhet të paraqitet pranë zyrave qendrore të Raiffeisen Bank sh.a. në adresën: Rruga "Tish Daija", Kompleksi KIKA 2, Tiranë brenda datës 23 Shkurt 2026.

> Mekanizmi i lojës promovionale

Fituesi i lojës promovionale do të përcaktohet me një përzgjedhje të rastësishme, nëpërmjet një programi kompjuterik.


Elementi që përcakton fituesit është Emri, Mbiemri, NRP, Qyteti/Rrethi dhe numri i kartës (i maskuar).

Programi software me anë të të cilit do të bëhet përzgjedhja e fituesve është ndërtuar nga Divizioni i TI-së pranë Raiffeisen Bank. Në këtë proces është siguruar që të mos ketë ndërhyrje njerëzore, por të gjitha të dhënat të gjenerohen automatikisht nga sistemi i bankut digjital. File me të dhënat e klientëve ngarkohet në sistemin e ndërtuar, i cili zgjedh në mënyrë rastësore një emër nga lista.

> Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me rregullat e përcaktuara në VKM nr.196, datë 15.3.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, formave, kritereve dhe rregullave për organizimin e lojërave të fatit promovionale".

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe është e vlefshme deri në përfundim të kësaj loje promovionale.



Make it happen

